



One Albania SHA

Adresa: Rruga "Muhedin Llagami", Kompleksi "Square 21", Tiranë, Shqipëri

Phone: +355 42275232 | E-mail: contactus@one.al

Certifikuar: ISO 9001 | ISO 45001 | ISO 14001 | ISO 37001 | ISO 37301 | ISO 27001 | ISO 20000 | BS PAS 99 | ISO 31000 |

NIPT: J61814094W

ANEKSI Nr. 1

KUSHTET E VEÇANTA TË SHËRBIMEVE DHE TARIFAVE

Në këtë Aneks, pasqyrohen shërbimet bazë dhe shtesë të ofruara nga ONE TELECOMMUNICATIONS SHA. dhe të zgjedhura nga Pajtimtari, kushtet e veçanta, tarifat përkatëse të shërbimeve si dhe mënyra e tarifimit.

- Plani ONE Elite me Kontrate

Programi	ONE Elite
Pajtimi Mujor	2,070
Minuta Kombëtare ¹	Pa limit
Minuta Ndërkombëtare	200
SMS Kombëtare/Ndërkombëtare* ¹	500
Internet ²	20GB
Internet Bonus	21GB
Internet me shpejtesi te reduktuar	Pa limit
Tarifat/Minutë (pas konsumimit të njësive falas)	
Minuta drejt të gjitha destinacioneve Kombëtare	9.20
Tarifat/Sekondë (pas konsumimit të njësive falas)	
Kombëtare	0.15
Shërbime të tjera	
SMS Kombëtare	4.09
SMS Ndërkombëtare	9.20
Tarifat ndërkombëtare/minutë (pas konsumimit të njësive falas)	
Zona 1	61.31
Zona 2	113.43
Zona 3	128.76
Zona 4	233.01
Zona 5	367.91
Tarifat ndërkombëtare/sekondë	
Zona 1	1.02
Zona 2	1.89
Zona 3	2.15
Zona 4	3.88
Zona 5	6.13
Internet ONE +	5GB – 500 Lekë
Paketat e Internetit Roaming	
Paketa Ditore Internet, 150 MB = 250 lekë	Paketat janë te vlefshme në të gjitha shtetet e Zonës 1
Paketa Javore Internet, 700 MB = 800 lekë	
Paketa Mujore Internet, 2GB = 2000 lekë	

1. Politika e drejtë e përdorimit për paketën me minuta falas pa limit do të jetë 5000 minuta.



One Albania SHA

Adresa: Rruga "Muhedin Llagami", Kompleksi "Square 21", Tiranë, Shqipëri
 Phone: +355 42275232 | E-mail: contactus@one.al
 Certifikuar: ISO 9001 | ISO 45001 | ISO 14001 | ISO 37001 | ISO 37301 | ISO 27001 | ISO 20000 | BS PAS 99 | ISO 31000 |
 NIPT: J61814094W

- Destinacionet e vlefshme per minutat ndërkombëtare te perfshira ne program – 30 shtete: Rumani, Austri, Bullgari, Suedi, Poloni, Norvegji, Republika Çeke, Sloveni, Kroaci, Greqi, Itali, Francë, SHBA, Kanada, Mbretëria e Bashkuar, Gjermani, Turqi, Zvicër, Belgjikë, Hollandë, Spanjë, Maqedoni, Kosovë, Serbi, Mali i Zi, Kina, Hungaria, Irlandë, Luksemburg, Danimarkë.
- SMS-të e përfshira në paketë janë të vlefshme drejt të gjitha destinacioneve kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Minutat dhe SMS kombetare jane te vlefshme edhe ne Roaming ne Ballkanin Perendimor.
- Maksimumi i vellimit te Internetit i cili eshte i vlefshem edhe ne Roaming ne Ballkanin Perendimor: 13.9 GB

Tarifat Standarde të Shërbimit Roaming:

1- Tarifat Standarde të Shërbimit Roaming per Ballkanin Perendimor:

Telefonata Dalese ne Roaming	KOMBETARE		DESTINACIONE TE TJERA	
	leke/minute	leke/sekonde	leke/minute	leke/sekonde
	9	0.15	120	2
Telefonata Hyrese ne Roaming	NGA SHTETET BP/Shqiperi		NGA DESTINACIONE TE TJERA	
	FALAS		leke/minute	leke/sekonde
			100	1.667
SMS Dalese ne Roaming	KOMBETARE		DESTINACIONE TE TJERA	
	Leke/SMS		Leke/SMS	
	4		15	
SMS Hyrese ne Roaming	FALAS			
Internet ne Roaming	leke/MB		leke/10KB	
	1.14		0.0111	

2- Tarifat Standarde të Shërbimit Roaming:

TELEFONATA NË ROAMING	TELEFONATA DALËSE NË ROAMING		TELEFONATA HYRËSE NË ROAMING	
	lekë/minutë	lekë/sekondë	lekë/minutë	lekë/sekondë
Zona 1	120.0000	2.0000	100.0000	1.6667
Zona 2	520.0000	8.6667	100.0000	1.6667
Zona 3	780.0000	13.0000	100.0000	1.6667
SMS në Roaming	SMS Dalëse lekë/SMS		SMS Hyrëse lekë/SMS	
Zona 1	15.0000		FALAS	
Zona 2	15.0000			
Zona 3	15.0000			
Internet në Roaming	lekë/MB		lekë / 10 KB	
Zona 1	50.0000		0.4880	
Zona 2	180.0000		1.7580	
Zona 3	1,600.0000		15.6250	



One Albania SHA

Adresa: Rruga "Muhedin Llagami", Kompleksi "Square 21", Tiranë, Shqipëri

Phone: +355 42275232 | E-mail: contactus@one.al

Certifikuar: ISO 9001 | ISO 45001 | ISO 14001 | ISO 37001 | ISO 37301 | ISO 27001 | ISO 20000 | BS PAS 99 | ISO 31000 |

NIPT: J61814094W

SHËNIME TË PËRGJITHSHME

- 1) Të gjitha tarifat e përcaktuara më sipër përfshijnë TVSH-në.
- 2) Benefitet e përfshira në program janë të vlefshme për një periudhë 1 muaj dhe nuk janë të transferueshme në muajt në vijim.
- 3) Pajtimi mujor dhe njësitë të përfshira në paketë (minuta, SMS, MB) janë proporcionale në varësi të datës së aktivizimit. Ky kusht aplikohet për të gjitha mënyrat e abonimit: aktivizim i ri, transferim, tjetërsim.
- 4) Koha fillestare e tarifimit është 60 sekonda, më pas do të aplikohet tarifimi për sekondë
- 5) Përlllogaritja e konsumimit të internetit do të bëhet për çdo 10 KB.
- 6) Interneti pas perfundimit të njesive do të jete me shpejtesi të reduktuar 128 Kbps. Pajtimtari mund të rikthejë shpejtësinë 4G të internetit brenda muajit duke blerë një paketë ekstra me GB sipas ofertave.
- 7) Pajtimtari që ka zgjedhur një prej planeve të tarifimit të mësipërme në fillim të çdo muaji do të përfitojë automatikisht Internet me shpejtësi 4G.
- 8) Pajtimtari mund të ndryshojë në çdo kohë planin e tij tarifor, në një plan tjetër tarifor me pajtim mujor më të lartë.
- 9) Kohëzgjatja fillestare, minimale e kontratës është 12 muaj. Në rast të zgjidhjes së parakohshme të kontratës prej Pajtimtarit brenda afatit fillestar 12 muaj apo 24 muaj, Pajtimtari ka detyrim të paguajë si penalitet, vlerën e tarifës mujore fikse për të gjithë muajt e mbetur deri në perfundimin e afatit të kontratës 12 muajore ose 24 muajore.
- 10) Në rastet kur Pajtimtari ka përfutur një zbritje në cmimin e aparatit të marrë si ofertë specifike, dhe kërkon zgjidhje të parakohshme të kontratës, përveç penalitetit të shënuar më sipër dhe vlerës së plotë korresponduese të ofertës specifike, duhet të paguajë gjithashtu dhe vlerën korresponduese të zbritjes së përfutur në çmimin e aparatit.
- 11) Në rastet kur pajtimtari ka përfutur nga ndonjë oferte promovionale si psh zbritje në pajtimin mujor, sipas kushteve të ofertes promovionale, dhe vendos të kryejë zgjidhje të parakohshme të kontratës, së bashku me detyrimet e sipërpërmendura duhet të paguajë edhe përfitimet nga oferta promovionale. (shumën e përfitimeve për të gjithë periudhën promovionale).
- 12) Në rast se Pajtimtari do të ndryshojë planin, nga një plan me pagesë fikse mujore më të lartë në një plan me pagesë fikse mujore më të ulët, ka detyrim të paguajë si penalitet, vlerën e diferencës së pagesës fikse mujore për të gjithë muajt e mbetur.
- 13) Në rastet kur Pajtimtari ka përfutur një zbritje në cmimin e aparatit të marrë si ofertë specifike, dhe kërkon të beje ndryshim e planit, nga një plan me pagesë fikse mujore më të lartë në një plan me pagesë fikse mujore më të ulët, ka detyrim të paguajë si penalitet, përveç penalitetit të shënuar më sipër duhet të paguajë gjithashtu dhe vlerën korresponduese të zbritjes së përfutur në çmimin e aparatit.
- 14) Në rastet kur pajtimtari ka përfutur nga ndonjë oferte promovionale si psh zbritje në pajtimin mujor, sipas kushteve të ofertës promovionale, dhe vendos do të ndryshojë planin, nga një plan me pagesë fikse mujore më të lartë në një plan me pagesë fikse mujore më të ulët, së bashku me detyrimet e sipërpërmendura duhet të paguajë edhe përfitimet nga oferta promovionale. (shumën e përfitimeve për të gjithë periudhën promovionale).
- 15) Kufiri maksimal i kreditimit i shprehur në lekë, për përdorimin e shërbimeve prej Pajtimtarit sipas programit të zgjedhur, përcaktohet në formularin e pajtimit bashkëlidhur, pjesë e pandashme e kontratës së pajtimit. Shuma e përcaktuar si limit krediti do të aplikohet në përputhje me planin tarifor të zgjedhur prej pajtimtarit. Ky kredit limit do të përdoret për shërbime të cilat nuk janë të përfshira në programin tarifor të zgjedhur, duke i ofruar Pajtimtarit fleksibilitet në përdorim dhe njëkohësisht edhe mundësi për të kontrolluar shpezimet. Pajtimtari mund të përditësojë në çdo moment limitin e kreditit. Ky përditësim mund të bëhet në çdo dyqan One.
- 16) Në faturën e pare do të pasqyrohen deryrimi i muajit paraardhës (proporcional) dhe pagesa fikse mujore e muajit aktual. Pagesat fikse mujore në vijim do të aplikohen çdo ditë të muajit kalendarik. Në faturën mujore të lëshuar, do të shfaqet vetëm vlera e pagesës mujore fikse e muajit aktual, sipas planit tarifor të zgjedhur.
- 17) Për të mesuar me shumë mbi shtetet dhe zonat ndërkombetare klikoni: <https://www.one.al/>
- 18) Për të mesuar me shumë mbi zonat, shtetet, operatorët, paketat dhe tarifat për njësi për shërbimin Roaming klikoni: <http://smartroam.one.al/>

SHËNIME PËR SHËRBIMIN ROAMING

- 19) Paketat, ofertat dhe koha e bisedës falas që pajtimtari ka përfutur duke aktivizuar ndonjë nga paketat bazë apo ato opsionale, nuk janë të vlefshme dhe nuk mund të konsumohen ndërkohë që klienti përdor shërbimin Roaming, përveç shteteve të Ballkanit Perëndimor.. Gjatë përdorimit të shërbimit Roaming, do të aplikohen tarifat e përcaktuara dhe të sipërpërmendura në tabelën 'Tarifat standarde të shërbimit Roaming'.



One Albania SHA

Adresa: Rruga "Muhedin Llagami", Kompleksi "Square 21", Tiranë, Shqipëri

Phone: +355 42275232 | E-mail: contactus@one.al

Certifikuar: ISO 9001 | ISO 45001 | ISO 14001 | ISO 37001 | ISO 37301 | ISO 27001 | ISO 20000 | BS PAS 99 | ISO 31000 |

NIPT: J61814094W

- 20) Interneti ne roaming do te tarifohet për çdo 10 KB. Pas përfundimit të MB të përfshira në paketë, do të aplikohen tarifat standarde të vlefshme në Roaming.
- 21) Koha fillestare e bisedës për telefonatat hyrëse dhe dalëse në Roaming është 60 sekonda. Pas përfundimit të kohës fillestare gjatë këtij shërbimi do të aplikohet tarifimi për sekondë.
- 22) Në mënyrë që të aktivizohet paketat internet te vlefshme per ne roaming (Paketa Ditore Internet dhe Paketa Javore Internet) pajtimtari duhet të sigurohet të aktivizojë shërbimin standard Roaming duke kontaktuar ONE nëpërmjet njëres prej pikave të shitjes.
- 23) Ne përputhje me dokumentin referencë ndëkombetar te përhershem te GSMA, datë 16.12.2014, Versioni 24.6, "Afatet për transferimin e te dhënave data" per marrëveshjet e Roaming ku shoqëria ONE TELECOMMUNICATIONS SHA është palë, në raste te vecanta, mund të krijohen vonesa të shkëmbimit të të dhënave roaming deri në 30 dite midis operatorëve në marrëdhënie roaming me njëri-tjetrin. Për këtë arsye, në keto raste detyrimi për pajtimtarin për shërbimet roaming të konsumuara në muajin paraardhes mund te pasqyrohen ne faturën në vijim në muajin pasardhes

SHËNIME TË TJERA PËR ZONËN BALLKANI PERENDIMOR:

- 24) Të gjithë Klientët që i përkasin programeve me kontratë ONE Simple, ONE Start, ONE More, ONE Advance, ONE Pro dhe ONE Elite, të rinj dhe ekzistues të cilët do të vizitojnë Shtetet e Ballkanit Perendimor do të mund te perdorin njesite e perfshira ne programin e tyre (minuta kombetare, SMS kombetare, Internet) FALAS sikur te ishin ne territorin Shqiptar, duke i zbritur ato nga programi perkates me konceptin Roam Like at Home (RLAH).
 - i. ONE ka te drejte te aplikojë Politiken e Perdoritit te Drejte te Sherbimit te te Dhenave ne Roaming sipas Rregullores se AKEP, specifikuar me siper.
 - ii. Pas konsumit te njesive data internet te lejuara ne programin perkates, ONE do te aplikojë nje tarife shtese prej 1.14 leke/MB.
- 25) Telefonata dhe SMS Dalese Kombetare quhen te gjitha thirrjet e gjeneruara nga shtetet e Ballkanit Perendimor dhe te terminuara ne operatoret celulare te shteteve te Ballkanit Perendimor dhe te Shqiperise."Destinacionet e tjera" jane operatoret fiks ne Shqiperi & Ballkanin Perendimor si dhe shtetet e tjera nderkombetare dhe do te tarifohen sipas tabelës me siper.
- 26) Thirrjet hyrese prej operatoreve celulare te Ballkanit Perendimor dhe Shqiperise jane FALAS. Te gjitha thirrjet e tjera te terminuara nga shtetet e tjera (operatoret fiks Shqiperi/ Ballkani Perendimor dhe shtetet e tjera nderkombetare) do te tarifohen sipas tabelës me siper.
- 27) Te gjitha SMS hyrese jane FALAS.
- 28) Tarifimi i minutave dalese do të kryhet fillimisht për 60 sekondat e para dhe më pas do të vazhdojë për çdo sekondë.
- 29) Tarifimi i minutave hyrese do te kryhet fillimisht per 30 sekondat e para dhe me pas do te vazhdoje per cdo sekonde.
- 30) Interneti do të tarifohet për çdo 10 KB.
- 31) Shteti i Kosovës, Bosnie Hercegovines, Mali i zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia do të vazhdojë të jetë te përfshirë tek paketat aktuale të vlefshme në Roaming dhe do të vazhdojnë të ofrohen në treg si një alternative shumë e mirë për klientët me kontratë. (te gjitha rrjetet janë të përfshira në këto paketa).Ne keto raste, njesite te perfshira ne program me konceptin RLAH do te kene prioritet mbi paketat Roaming.

Pajtimtari deklaron se ka lexuar dhe është plotësisht në dijeni të Kushteve të Përgjithshme të dhënies së shërbimeve të telefonisë publike të lëvizshme për Pajtimtarin, të cilat janë pasqyruar dhe mund të aksesohen në link-un e mëposhtëm:

<https://www.one.al/kompania/kushtet-e-pergjithshme-te-ofrimit-te-sherbimeve/>

Pajtimtari deklaron se i ka pranuar pa rezerva dhe nën vullnetin e tij të lirë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës së Patjimit.

Këto Kushte të Përgjithshme së bashku me Kushtet e Veçanta të Shërbimeve dhe Tarifave në fuqi, përbëjnë tërësinë e marrëveshjes ndërmjet palëve për ofrimin e shërbimeve të telekomunikacioneve prej ONE dhe faturimin përkatës të Pajtimtarit.

Për dhe në emër të ONE

Firma – Vula

Pajtimtari/ Përfaqesuesi i Autorizuar

Firma



One Albania SHA

Adresa: Rruga "Muhedin Llagami", Kompleksi "Square 21", Tiranë, Shqipëri

Phone: +355 42275232 | E-mail: contactus@one.al

Certifikuar: ISO 9001 | ISO 45001 | ISO 14001 | ISO 37001 | ISO 37301 | ISO 27001 | ISO 20000 | BS PAS 99 | ISO 31000 |

NIPT: J61814094W

.....
(emri-mbiemri)

.....
(emri-mbiemri)